

MBAHET MBLEDHJA E PARË E KOMISIONIT AD-HOC PËR VERIFIKIMIN DHE VLERËSIMIN PARAPRAK TË KANDIDATËVE PËR ANËTARË TË KLGJ DHE KLP NGA RADHËT E AVOKATISË Referuar nenit 26 dhe 124 të nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, pas përfundimit të procedurave për ngritjen e Komisionit të Pavarur Ad Hoc, Avokati i Popullit, në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Pavarur Ad Hoc, thirri sot, e enjte 24.08.2023 mbledhjen e parë të tij, pranë zyrave të Avokatit të Popullit. Pjesëmarrës në mbledhje ishin: Erinda Ballanca, Avokate e Popullit në cilësinë e Kryetarit, ndërsa në cilësinë e anëtarëve: Sandër Simoni, Ilir Dode, Shaban Sinani dhe Maksim Haxhia (në mungesë).

Rendi i ditës së mbledhjes përfshiu: Konstituimin e Komisionit Ad-Hoc; Diskutime për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit Ad-Hoc; Njohja me ecurinë e procesit të deritanishëm, etj.

Mbledhja e rradhës do të zhvillohet më datë 7 shtator, ora 09.00.